- 5 Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e strukturës më të lartë (Departamentit, Drejtorisë ose Sektorit sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete, në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete, emertësa e titullarit, sipas organikës.
- 6 Përjashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produktet i pozicioneve të posacme të punës, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës perkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçem sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të interesit, Koordinatorin për të drejtën e Informimit, Njësia e Burimeve Nerëzore etj.
- 7 Njësia e Prokurimeve, Grupet ad – hoc të punës, Komisioni i Ekspertizës si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues shënohen si nënstrukturë, poshtë strukturës me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.
- 8 Sekretari – Arkivi i institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhëri.
- 9 Në nenin 16 “ Dispozita Kalimtare”, të vendimit Nr.4, datë 19.06.2017 të Këshillit të lartë të Arkivave, mbas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje :
 6. Përjashtimisht për vitin 2024, në urdhërin nr 02. Datë 03.01.2024 “ Për njësimin e dokumentit administrative sipas shtojcës nr.9 dhe modelet e akteve zyrtare bashkëngjitur këtij urdhëri do të përdoret logoja e miratuar nga Komisioni Shtetëror për organizimine veprimtarive në kuadër të “ Viti mbarëkombëtar i 80 – vjetorit të Çlirimit”.
- 10 Ngarkohen strukturat e institucionit, pozicionet e posacme të punës sipas ligjit dhe Sekretari – Arkivi për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

PROF.DR BEKTASH NEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 798 prot.

Gjirokastër, më 23.05.2024

URDHËR

Nr. 32 datë 23.05.2024

"PËR PAGESËNE E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024"

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, të V.K.M Nr.288, datë 21.5.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" të ndryshuar, V.K.M Nr. 778 datë 26.12.2018, V.K.M.-së me Nr.40 datë 23.01.2019, si edhe vendimeve të Bordit të Administrimit,

URDHËROJ

- 1-Studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve apo edhe ciklin e dytë të studimeve duhet të kryejnë pagesën e tarifës vjetore të shkollimit para fillimit të sezonit të dytë të vitit akademik 2023-2024, si dhe të pajisen me vërtetim nga arka për tu futur në provime.
- 2-Sekretaret mësimore të përfshijnë në proces verbalet e provimit vetëm studentët që nuk kanë detyrime financiare.
- 3-Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, Kryesekretari.
- 4- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTORI

Prof.Dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 889 Prot.

Gjirokastrë, më 30.05.2024

V E N D I M

Nr. 33, datë 30.05.2024

P Ë R

MIRATIMIN E DORËHEQJES

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Satutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30 pika 2, si dhe në kërkesën e Prof.asoc. Gjergji Semini me nr. 885 prot., të datës 30.05.2024.

V E N D O S A:

1. Prof.asoc.Gjergji Semini deri më sot në pozicionin e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Infermierisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ti miratojë dorëheqjen.
2. Marrëdhëniet juridike dhe financiare me Universitetin i ndërpriten në datën 31.05.2024.
3. Vendimit i bashkëlidhet letër dorëheqja.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 899 Prot.

Gjirokastrë, më 31.05.2024

URDHËR

Nr. 34, datë 31.05.2024

"PËR

EMËRIMIN E SPECIALISTIT PËR PROJEKTE ME KOHËZGJATJE TË PACAKTUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, neni 149 "Kontrata me afat të caktuar", Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 Personeli ndihmës akademik pika 3 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.3.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe në nenin 54 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. Emërimin e znj. **Jonilda Llupa**, "Specialiste për Projekte" në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënjeve me Jashtë, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndhmësakademike Administrative.
2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë me kohë të pacaktuar.
3. Kategoria e pagës IV-2.
4. Efektet financiare data 01.06.2024.(në vijushmëri.)
5. Ngarkohet me zbatimin Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndhmës Akademike – Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër i njoftohet të interesuarit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 908/1, Prot.

Gjirokastrë, më 31.05.2024

URDHËR

Nr. 35, datë 31.05.2024

"PËR DHËNIE LEJE NGA LEJA VJETORE"

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kod i Punës i Republikës të Shqipërisë I përditësuar, Vendimit nr. 568, datë 06.10.2022 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucioneve të pavaruara dhe njesitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së zjn. Briseida Kamemaj, me shkresë nr.908,prot.datë 31.05.2024.

URDHËROJ:

1.Ti jepet leje nga leja vjetore Znj. **Briseda Kamemaj**, në pozicionin asiten specialiste e Rektorit dhe sekretar i senatit akademik, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative.

Kohëzgjatja e lejes do të jetë nga data 21.05.2024 deri më 22.05.2024.

Paraqitja në punë më datë 23.05.2024.

Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 923 Prot

Gjirokastrë më 03.06.2024

URDHËR

Nr. 36, datë 03.06.2024

PËR

**KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË SIGURISË NË
DIPLOMA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 91 si dhe Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për vendosjen e elementëve të sigurisë për prodhimin e diplomave kundër dublimit apo falsifikimit me këtë përbërje:
 - Prof. dr Jaho Cana
 - Zj. Violeta Serjani
 - Zj. Ornela Mera
 - Z. Vladimir Belaj
 - Zj. Borana Lelaj
2. Komisioni ngarkohet për ruajtjen e sekretit të të dhënave.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri anëtarët e mësipërm sipas pikës 1 të këtij Urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTOR

Prof. dr Bektash MEHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REKTORI

Nr. 932 Prot

Gjirokastër, më 04.11.2024

URDHËR

Nr. 37, datë 04.06 2024

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 32, DATË 23.05.2024 "PËR PAGESËN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024"

Në zbatim të nenit 98 pika 2/c të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenin 89 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; VKM-së nr. 288, datë 2.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 26.12.2018, VKM-në nr. 40, datë 23.01.2019, si dhe vendimeve të Bordit të Administrimit,

URDHËROJ

1. Pika 2 (dy) e urdhërit të Rektorit, nr. 32, datë 23.05.2024 "Për pagesën e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2023-2024", ndryshon si më poshtë:

"Sekretaria mësimore, lidhur me pagesën e tarifës studentore të shkollimit, të veprojë në përputhje me nenin 61, pika 3, të rregullores së universitetit".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1052 Prot.

Gjirokastrë, më. 03/07/2024

URDHËR

Nr. 38, datë 03.07.2024

PËR

SHTYRJE AFATI TË KONTRATËS SË PUNËS

Bazuar në nenet 19/1, 20, 21 të Kodit të Punës; nenit 39 pika 5 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 30 pika 1/k të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; shkresën nr. 117, datë 03.04.2024 të Dekanit të FESHSH

URDHËROJ

1. Znj. Zamira Kote, në mbështetje të propozimit të drejtuesit të njësisë kryesore të FESHSH, si dhe të kërkesës së drejtuesit të njësisë bazë të gjuhëve të huaja, të vazhdojë të jetë pjesë e njësisë bazë të gjuhëve të huaja, pavarësisht arritjes së moshës së pensionit të kërkuar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
2. Kontrata e re e punës do të jetë me afat të caktuar, deri në përfundimin e vitit akademik 2023-2024, fillon më datë 19.07.2024 deri më 30.09.2024 që përkon edhe me fundin e vitit akademik.
3. Kontrata e re do të nënshkruhet nga palët pa u ndërprerë marrëdhënjet e punës.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1056 prot.

Gjirokastër, më 04.07. 2024

URDHËR

Nr. 39, datë 04.07.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STUDENTËVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË
MOBILITET NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30, Thirrjes për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin INTERCON, Spanjë, nr. 1019 prot., dt 24.06.2024, dhe "Marrëveshjes Ndërinstitucionale, nr. 1051 Prot, datë 02.07.2024" të nënshkruar nga autoritetet e IES Abastos, Spanjë dhe Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër,

URDHËROJ:

Ngritjen e Komisionit AD HOC për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve që do të përfshihet në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|----------|
| 1. Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| 2. Prof. dr. Jaho Cana | Anëtar |
| 3. Msc. Irma Gjollëshi | Anëtare |

Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët e interesuar për mobilitet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. BEKTASH MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1057 prot.

Gjirokastër, më 04.07. 2024

URDHËR

Nr. 140, datë 04.07.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STUDENTËVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË
MOBILITET NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30 dhe Thirrjes për shkëmbim studentësh në kuadër të Programit Erasmus+ me Universitetin Mesdhetar të Kretës, nr. 1048 prot., dt 02.07.2024,

URDHËROJ:

Ngritjen e Komisionit AD HOC për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve që do të përfshihet në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|----------|
| 1. Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| 2. Prof. asoc. Selfo Oruçi | Anëtar |
| 3. Msc. Irma Gjolleshi | Anëtare |

Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët e interesuar për mobilitet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. BEKTASH MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1088 prot.

Gjirokastrë, më 08.07. 2024

URDHËR

Nr. 41, datë 08.07.2024

PËR

**NGRITJEN E GRUPEVE TË PUNËS PËR PROCESIN E PËRLLLOGARITJES
SË PIKËVË DHE REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE TË RINJ PËR VITIN
AKADEMIK 2024-2025, PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ".**

Në zbatim të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023“ Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, urdhërit të përbashkët të QSHA-së dhe RASH-it nr. 112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procesin e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2024 – 2025”, si dhe propozimeve të Njesisë Kryesore FESHSH nr. 121 prot, datë 08.07.2024, Njesisë Kryesore FE nr. 67 prot, datë 08.07.2024, dhe Njesisë Kryesore FSHN nr. 73, datë 08.07.2024;

Urdhëroj;

1. Ngritjen e grupeve të punës për procesin e përlllogaritjes së pikëve për aplikantët në programet e ciklit të parë dhe programeve me karakter profesional. (sipas shtojcës bashkëlidhur)
2. Ngritjen e grupeve të punës për procesin e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj në të gjitha programet e studimit për ciklin e parë, ciklin e dytë, programeve të dyta të studimit dhe transferimeve të studimeve. (sipas shtojcës bashkëlidhur).

3. Mbikëqyrja e gjithë procesit të regjistrimit dhe aplikimit për pranimet e studentëve të rinj do të bëhet nga Përgjegjësjë e Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave në UGJ znj. Klaviona Dudumi.
4. Rikthimi në punë i grupit të punës për procesin e përlllogaritjes së pikëve të aplikantëve në programet e ciklit të parë dhe programet me karakter profesional do të jetë data 21.08.2024.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Beqtash M. M. M.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1096 Prot

Datë 09/07 2024

URDHËR

Nr. 42, datë 09.07 2024

PËR

**PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD-HOC TË VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE SHKENCORE
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 39, pika 12 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 30 pika 1/a të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; të nenit 85 të Rregullores së Universitetit, Rektori bazuar në propozimet e drejtuesëve të njësive kryesore me nr. 122, datë 09.07.2024, nr. 69, datë 09.07.2024 dhe nr. 74, datë 08.07.2024, me objekt propozim për caktimin e anëtarëve të komisionit ad-hoc për vlerësimin e projekteve shkencore të paraqitura nga personeli akademik i njësive bazë dhe të financuara nga buxheti i universitetit

URDHËROJ:

1. Përbërjen e komisionit ad-hoc për vlerësimin e projekteve shkencore të paraqitura nga personeli akademik i njësive bazë dhe të financuara nga buxheti i universitetit, si më poshtë vijon:
 - a. Prof.as.dr. Merita Isaraj, Zv/Rektor për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë;
 - b. Prof.as.dr. Spiridhulla Poci, përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - c. Dr. Mirela Taçi (Saraçi), përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - d. Dr. Arjola Mitaj, përfaqësuese e Fakultetit Ekonomik;
 - e. Dr. Dhori Terpo, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
2. Urdhërit i bashkëlidhen propozimet e drejtuesve të njësive kryesore.
3. Urdhëri i përcillet administratorit të institucionit, drejtuesëve të njësive kryesore dhe anëtarëve përkatës të komisionit ad-hoc.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

REKTORI

Prof.dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1098 prot.

Gjirokastër, më 09.07. 2024

URDHËR

Nr. #3, datë 09.07.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STAFIT QË DO TË PËRFSHIHET NË MOBILITET NË
KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30 dhe Thirrjes për shkëmbim stafi në kuadër të Programit Erasmus+ me Universitetin Mesdhetar të Kretës, nr. 10487 prot., dt 02.07.2024,

URDHËROJ:

Ngritjen e Komisionit AD HOC për vlerësimin e dokumentacionit të stafit që do të përfshihet në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|----------|
| 1. Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| 2. Prof. dr. Jaho Cana | Anëtar |
| 3. Msc. Irma Gjolleshi | Anëtare |

Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët e interesuar për mobilitet.

Ky Urdhër hyj në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. BEKTASH MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRIS
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1103 Prot

Datë 10.10 2024

URDHËR

Nr. 44, datë 10.07 2024

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 42, DATË 09.07.2024 "PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD-HOC TË VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE SHKENCORE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 39, pika 12 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 30 pika 1/a të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; të nenit 85 të Rregullores së Universitetit; në propozimet e drejtuesëve të njësive kryesore me nr. 122, datë 09.07.2024, nr. 69, datë 09.07.2024 dhe nr. 74, datë 08.07.2024, Rektori, pas informacionit të marrë nga sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë se pjesë e projekteve është dhe Zv/Rektorja Prof.as.dr. Merita Isaraj dhe si e tillë nuk duhet të jetë në përnjërjen e komisionut ad-hoc

URDHËROJ:

1. Përbërjen e komisionit ad-hoc për vlerësimin e projekteve shkencore të paraqitura nga personeli akademik i njësive bazë dhe të financuara nga buxheti i universitetit, si më poshtë vijon:
 - a. Prof.as.dr. Spiridhulla Poci, përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - b. Dr. Mirela Taçi (Saraçi), përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - c. Dr. Arjola Mitaj, përfaqësuese e Fakultetit Ekonomik;
 - d. Dr. Dhori Terpo, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
 - e. Dr. Jonilda Llupa, përfaqësuese e Rektoratit
2. Urdhërit i bashkëlidhen propozimet e drejtuesve të njësive kryesore.
3. Urdhëri i përcillet administratorit të institucionit, Zv/Rektores për kërkimin shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë, drejtuesëve të njësive kryesore, anëtarëve përkatës të komisionit ad-hoc dhe sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTORI

Prof.dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1212 Prot

Gjirokastrë më, 23.08.2024

URDHËR

Nr. 45, datë 23.08.2024

PËR

MIRATIMIN E VITIT SABATIK PËR PERSONELIN AKADEMIK BELINDA XARBA

Bazuar në nenin 39, pika 12 të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 30, pika 1/1 dhe nenit 53 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", në kërkesën e personelit akademik Lektore Belinda Xarba dhe miratimin e saj nga njësia bazë përkatëse, përcjellë Rektorit nga Dekani i FE me shkresën nr.1211.prot, datë 23.08.2024 me objekt " Dhënie e së drejtës për ushtrimin e vitit sabatik", konstatova se gjithë dokumentacioni është konformë akteve ligjore e nënligjore. Mbi këtë bazë:

URDHËROJ:

1. Lektore Belinda Xarba ti jepet e drejta e ushtrimit të vitit sabatik, me shtrirje kohore nga data 02.09.2024 deri më datë 01.09.2025
2. Urdhërit i bashkëlidhet vendimi i Njesisë Bazë dhe shkresa përcjellëse.
3. Urdhëri i përcillet Dekanit të FE, Përgjegjësit të Njesisë Bazë të Kontabilitet – Financës si dhe përfituesit të vitit sabatik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTORI

PROF.DR.BEKTASH MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1230 Prot

Gjirokastrë më, 27.08.2024

URDHËR

Nr. 46, datë 27.08 2024

PËR

LIRIM NGA DETYRA

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 40 pika 2, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 31;

URDHËROJ

1. Lirimin nga detyra të **Prof.dr. Jaho Cana**, deri më tani në detyrën e Zv/rektorit për procesin mësimor dhe njëkohësisht i komanduar si Drejtues i Njësisë Kryesore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Marrëdhëniet financiare i ndërpriten më datë 27.08.2024.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZV/ REKTORE

Prof. Asoc. Merita Isaraj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1232 Prot

Gjirokastrë më, 27.08.2024

URDHËR

Nr. 47, datë 27.08 2024

PËR

**LIRIM NGA DETYRA DHE EMËRIM PERSONELI AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË
DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 pika 7, neni 65, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, me propozim të Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë datë 23.08.2024 përcjellë rektorit nga Dekani i FESHSH me shkresë nr.128 Prot. datë 27.08.2024;

URDHËROJ

1. Lirimin nga detyra të **Prof. Dr. Bektash Mema**, deri më tani në detyrën e Rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Emërimin në detyrën e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar në Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
3. Afati kontratës do të jetë nga data 27.08.2024 deri më 30.09.2025.
4. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 27.08.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si personel akademik fillojnë më datë 27.08.2024.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike-administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1238 Prot

Gjirokastër më, 30/08 /2024

URDHËR

Nr. 48, datë 30.08 2024

PËR

EMËRIM NË DËTYRË

TË DREJTUESIT TË NJËSISË KRYESORE NË

FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 42 pika 5, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30, pikal/n, Rregullore "Për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 41 pika 4 si dhe me shkresë të KIZ nr. 1228 Prot. datë 27.08.2024;

URDHËROJ

1. Emërimin në detyrën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër. **Prof. Asoc. Valbona Duri.**
2. Të paguhet me pagë sipas akteve ligjore në fuqi.
3. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 02.09.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si Drejtues i Njesisë Kryesore në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore fillojnë më datë 02.09.2024.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Ndihmësakadematike-Administrative, Drejtorja e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. JAHO ÇABEJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1239 Prot

Gjirokastër më, 30/08 /2024

URDHËR

Nr. 49, datë 30/08 2024

PËR

LIRIM DHE EMËRIM NË DËTYRË
TË DREJTUESIT TË NJËSISË KRYESORE NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 42 pika 5, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 32, Rregullore "Për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 41 pika 4 si dhe me shkresë të KIZ nr. 1228 Prot. datë 27.08.2024;

URDHËROJ

1. Lirimin nga detyra e Përgjegjës të Njesisë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit.
2. Emërimin në detyrën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër **Prof. Asoc. Sadik Malo**.
3. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 02.09.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si Drejtues i Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës fillojnë më datë 02.09.2024
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike-administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. JAHOR ÇABA

Adresa: Lagja "18 Shtatori", Rr. "Studenti", Gjirokastër
Kodi postar: 6001, ceb@ueg.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1240 Prot

Gjirokastër më, 30/08 /2024

URDHËR

Nr. 50, datë 30.08 2024

PËR

EMËRIM NË DËTYRË

TË DREJTUESIT TË NJËSISË KRYESORE NË

FAKULTETIT EKONOMIK

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 42 pika 5, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 32, Rregullore "Për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 41 pika 4 si dhe me shkresë të KIZ nr. 1228 Prot. datë 27.08.2024;

URDHËROJ

1. Emërimin në detyrën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Prof. Asoc. Lorenc Koçiu.
2. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 02.09.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si Drejtues i Njesisë Kryesore në Fakultetin Ekonomik fillojnë më datë 02.09.2024.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyj në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. JAHO ÇABEJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1242 Prot

Gjirokastër më, 30/08/2024

URDHËR

Nr. 52, datë 30.08 2024

PËR

**LIRIM NGA DETYRA DHE EMËRIM PERSONELI AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË
DHE KOHËZGJATJE TË PACAKTUAR**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 si dhe neni 42 pika 4, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30 pika 2;

URDHËROJ

- 1.Lirimin nga detyra të **Prof. Asoc. Selfo Oruçi**, deri më tani në detyrën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.
- 2.Kalimin në detyrën e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
- 3.Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 02.09.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit fillojnë më datë 02.09.2024.
- 4.Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Dekani i FSHN, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1278 Prot.

Gjirokastrë më, 04.09.2024

URDHËR

Nr. 53, datë 04, 09, 2024

PËR
NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 01, DATË 03.01.2024 NË PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË EKSPERTIZËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" neni 7, "Normave tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" neneve 32, 33, 34, 35, Vendimit Nr. 4 datë 19.06.2017 "Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" neni 5 si dhe Dekretit të Presidentit nr.318, datë 26.08.2024

URDHËROJ :

1. Ndryshimin e Kryetarit të Komisionit të Ekspertizës, pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ngritur me Urdhër nr. 01, datë 03.01.2024 nga Prof. Dr Bektash Mema në Prof. Dr Jaho Cana.
2. Ngarkohen për njohje antarët e tjerë të grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 1308 Prot

Gjirokastrë më, 10 / 09 / 2024

URDHËR

Nr. 54, datë 10.09 2024

PËR

EMËRIM NË DËTYRË TË ZËVËNDËSREKTORIT PËR PROCESIN MËSIMOR

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 40 pika 2, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 31 pika 2, Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar si dhe si dhe vendimin e Senatit Akademik nr. 46 , datë 10.09.2024 me nr.1305 prot;

URDHËROJ

1. Emërimin në detyrën e Zëvendësrektorit "Për Procesin Mësimorë" në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Prof. Dr. Gëzim Sala.
2. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 09.09.2024
3. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri i fillojnë më datën 10.09.2024
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakadematike-Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA

Adresa: Lagja "18 Shtatori", Rr. "Studenti", Gjirokastrë
Kodi postar: 6001, eeb:ëëë.uogj.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REKTORI

Nr 1344 Prot.

Gjirokastër, më 13.09.2024

URDHËR

Nr. 55, datë 13.09.2024

PËR

PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD-HOC TË VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE SHKENCORE
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 39 pika 12; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 30 pika 1/a; Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej", neni 85; Thirrjes së Zv/Rektores për marrëdhëniet me jashtë dhe kërkimin shkencor, Nr. 1280 Prot., datë 04.09.2024;

URDHËROJ;

1. Përbërjen e komisionit ad-hoc për vlerësimin e projekteve shkencore të financuara nga buxheti i universitetit, si më poshtë vijon:
 - a. Dr.Dhori Terpo, (kryetar) përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 - b. Prof.as.dr.Spiridhula Poçi, (anëtare) përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - c. Dr. Mirela Taçi, (anëtare) përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
 - d. Msc. Irma Gjollëshi, (anëtare) përfaqësuese e Rektoratit ;
 - e. Dr. Jonilda Llupa, (anëtare) përfaqësuese e Rektoratit;
2. Urdhëri i përcillet administratorit të institucionit, zv/rektores për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë, drejtuesve të njësive kryesore, anëtarëve përkatës të komisionit ad-hoc dhe sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTOR

Prof. dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1350 prot.

Gjirokastrë, më 16.09. 2024

URDHËR

Nr. 56, datë, 16.09. 2024

PËR

ORGANIZIMIN E MËSIMDHËNIES NË VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 87 ; Statutit të universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 74 ; urdhërit të MAS-it nr. 192, datë 30.04.2024 " Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2024 – 2025 në Institutet e Arsimit të Lartë" :

URDHËROJ ;

1. Fillimin e vitit akademik 2024-2025 në datën 7 tetor 2024 dhe mbarimin e tij në datën 26 shtator 2025.
2. Periudha 23 dhjetor 2024 deri më 3 janar 2025; do të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Njësitë bazë të hartojnë strukturën mësimore dhe ta miratojnë pranë Njësisë kryesore përkatëse sipas semestrave.
4. Një kopje e strukturës mësimore depozitohet pranë Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative të UGJ-së.

Ky urdhër hyu në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1355 Prot.

Gjirokastrë më, 16.09.2024

URDHËR

Nr. 57, datë 16, 09, 2024

PËR

KOMANDIMIN E DREJTUESIT TË NJËSISË BAZË TË KONTABILITET - FINANCËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 36 pika 2, nenit 39 pika 1, neni 42 pika 9, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30, Rregullores "Për orgnizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" neni 4 pika 12, propozimit "Për komandimin e Drejtuesit të Njesisë Bazë" nr. 85 prot, datë 06.09.2024 si dhe referuar shkresës së KIZ nr. 1249 prot, datë 30.08.2024 "Për rezultatin e zgjedhjeve të zhvilluara";

URDHËROJ:

1. Komandimin e Drejtuesit të Njesisë Bazë të Kontabilitet - Financës në Fakultetin Ekonomik Dr. Etleva Petaj.
2. Funkcionet përgjatë kohës së komandimit do të jenë sipas të gjithë të drejtave dhe detyrave që parashikon ligji dhe aktet nën ligjore për arsimin e lartë.
3. Afati i komandimit do të zgjasë deri në një urdhër të dytë.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Fakulteti Ekonomik, Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Ndihmësakadematike - Administrative si dhe Drejtorja e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1356 Prot.

Gjirokastrë më, 16.09.2024

URDHËR

Nr. 55, datë 16, 09, 2024

PËR

KOMANDIMIN E DREJTUESIT TË NJËSISË BAZË TË ADMINISTRIMIT PUBLIK

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 36 pika 2, neni 39 pika 1, neni 42 pika 9, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30, Rregullores "Për orgnizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" neni 4 pika 12, propozimit "Për komandimin e Drejtuesit të Njesisë Bazë" nr. 85 prot, datë 06.09.2024 si dhe referuar shkresës së KIZ nr. 1249 prot, datë 30.08.2024 "Për rezultatin e zgjedhjeve të zhvilluara";

URDHËROJ :

1. Komandimin e Drejtuesit të Njesisë Bazë të Administrimit Pubilk në Fakultetin Ekonomik Dr. Arjola Mitaj.
2. Funkcionet përgjatë kohës së komandimit do të jenë sipas të gjithë të drejtave dhe detyrave që parashikon ligji dhe aktet nën ligjore për arsimin e lartë.
3. Afati i komandimit do të zgjasë deri në një Urdhër të dytë.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Fakulteti Ekonomik, Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndhmësakadematike - Administrative si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1380 prot.

Gjirokastrë, më 20.09. 2024

URDHËR

Nr. 59, datë, 20.09.2024

PËR

**ORGANIZIMIN E NJËSIVE BAZË NË GRUPE MËSIMORE ME KARAKTER KËRKIMOR
SHKENCOR**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 pika 1, pka 5 ; Statutit të universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 12 pika 1/1, neni 14 ; urdhëzimit nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", pika 8 ;

URDHËROJ ;

1. Njësitë bazë pranë njësive kryesore të UGJ-së , të riorganizohen në grupe mësimore me karakter kërkimor – shkencor, sipas përcaktimeve ligjore, për ato njësi bazë të cilat plotësojnë numrin e personelit akademik të nevojshëm.
2. Brenda datës 30.09.2024, njësitë kryesore të përcjellin pranë Rektoratit propozimet tyre për organizimin në grupe mësimore kërkimore – shkencore të njësive bazë.
3. Urdhëri i përcillet zëvendës Rektorit për procesin mësimor , drejtuesve të njësive kryesore dhe drejtuesve të njësive bazë, të cilët ngarkohen për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof.dr Jaho ÇABA

REKTOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REKTORI

Gjirokastrë më, 23.09.2024

URDHËR

Nr. 60, datë 23.09.2024

PËR

**LIRIM NGA DETYRA DHE EMËRIM PERSONELI AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË
DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 pika 7, neni 65, pika 2, VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personeli akademik", Udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, me propozim të Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek datë 29.08.2024 përcjellë rektorit nga Dekani i FESHSH me shkresë nr.130 Prot. datë 29.08.2024;

URDHËR O J:

1. Lirimin nga detyra të **Prof. Asoc. Panajot Barka**, deri më tani me detyrë Përgjegjës i Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.
2. Kalimin në detyrën e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësinë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek.
3. Afati kontratës do të jetë nga data 25.09.2024 deri më 30.09.2025.
4. Marrëdhëniet financiare në pozicionin e mëparshëm i ndërpriten më datë 24.09.2024 dhe marrëdhëniet financiare në pozicionin e ri si personel akademik fillojnë më datë 25.09.2024.
5. Pagesa do të bëhet në bazë të VKM-së Nr.243, datë 20.04.2023 "Për trajtimin me pagë me shtesa mbi pagë të punonjësve të personeli akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë" i ndryshuar, nga kategoria "Profe. asoc".
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Dekani i FESHSH, Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Ndihmësakademi-Administrative dhe Drejtorja e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA

Adresa: Lagja "18 Shtatori", Rr. "Studenti", Gjirokastrë
Kodi postar: 6001, ëëëëë.uogj.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1407 Prot.

Gjirokastrë më, 23.09.2024

URDHËR

Nr. 61, datë 23, 09, 2024

PËR
KOMANDIMIN E DREJTUESIT TË NJËSISË BAZË TË GJUHËS, LETËRSISË DHE
QYTETËRIMIT GREK

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 36 pika 2, neni 39 pika 1, neni 42 pika 9, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30, Rregullores "Për orgnizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" neni 4 pika 12, propozimit "Për komandimin e Drejtuesit të Njesisë Bazë" nr. 145 prot, datë 20.09.2024 si dhe referuar shkresës së KIZ nr. 1249 prot, datë 30.08.2024 "Për rezultatin e zgjedhjeve të zhvilluara";

